



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për transportin rrugor nr.2004/1, nenit 19, paragrafi 1 (dh) dhe nenit 40, paragrafi 1 (d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005, miratoi këtë

RR E G U L L O R E PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME “MERIMANGË”

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen kushtet dhe mënyra e ushtrimit të shërbimit të transportit me “merimangë” në territorin e komunës së Prishtinës.

Neni 2

- 2.1. Shërbimi i transportit me “merimangë” nënkupton tërheqjen-bartjen e automjeteve të marrura nga vendet ku është i ndaluar qëndrimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ose që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim.
- 2.2. Vendin (lokacionin) për vendosjen e automjeteve, nga paragrafi paraprak, e cakton Kuvendi i Komunës.
- 2.3. Mënyrën e organizimit të bartjes së automjeteve me “merimangë” e përcakton Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore (më poshtë i qujtur: Drejtorati).
- 2.4. Tërheqja-bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë dhe të Inspektorit komunal të komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.
- 2.5. Operatori i transportit me “merimangë” do të caktohet përmes tenderit të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me “merimangë”, në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

Neni 3

- 3.1. Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit me “merimangë” (më poshtë i qujtur: Operatori) –fituesin e tenderit, me të cilën më për së afërmi do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.
- 3.2. Kontrata, nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar, por jo më gjatë se për 1 (një) vit.

3.3. Automjeti që nuk tërhiqet nga vendi i caktuar në nenin 1.2.të kësaj Rregulloreje, në afatin prej 2 (dy) muajsh, nga dita e vendosjes në atë vend, kalon në pronë të Komunës.

3.4. Komuna mund të shesë automjetet nga paragrafi paraprak përmes ankandit publik.

Neni 4

4.1. Në momentin e tërheqjes-marrjes së automjetit nga Operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkojë edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar atë, para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

4.2. Operatori nuk duhet të shtyjë lëshimin e automjetit kur pronari ose drejtuesi i automjetit jep dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bënë pagesën e taksës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 5

Kushtet për shërbimin e transportit me “merimangë”

Operatori duhet:

5.1. të jetë i regjistruar për ushtrimin e shërbimit të transportit me “merimangë”,

5.2. të ketë së pakut 3 (tre) automjete për bartjen e automjeteve,

5.3. të ketë së paku 20 (njëzet) bllokues rrotash ngjyrë të verdhë,

5.4. të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,

5.5. të sigurojë shërbimin 24 orësh 7 (shtatë) ditë në javë,

5.6. të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 6

Kushtet për automjetet bartëse

Automjetet duhet:

6.1 të jenë të regjistruara,

6.2. të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve,

6.3. të jenë teknikisht në rregull në çdo kohë,

6.4. t'i kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,

6.5. të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe

6.6. të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Neni 7

Kushtet për drejtuesit e automjeteve

Drejtuesit e automjeteve duhet:

- 7.1. të jenë punëtorë të operatorit,
- 7.2. të kenë patentshoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjësisht,
- 7.3. të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes.

Neni 8

Pagesat për lirim (rimarrjen) e automjetit

8.1. Operatori, si kusht për lirimin e automjetit, pronarin, përkatësisht drejtuesin e automjetit do t`a ngarkojë me pagesat si më poshtë:

- për tërheqjen e autovecurave brenda qytetit do të paguhet 15,00 € për operatorin dhe 15,00 € për Komunën;
- për tërheqjen e kombibusëve dhe xhipave brenda qytetit do të paguhet 20,00 € për operatorin dhe 20,00 € për Komunën;
- për tërheqjen e kamionëve dhe autobusëve brenda qytetit do të paguhet 80,00 € për operatorin dhe 80,00 € për Komunën, dhe
- për tërheqjen e automjeteve nga zonat jashtë qytetit, përveç çmimeve të lartë shënuara, do t`i paguhet operatorit edhe shuma prej 0,25 € për km. në njërin drejtim, pa ngarkesë, dhe 0,50 € për km. në drejtimin tjetër me ngarkesë;
- në rast se pronari, përkatësisht drejtuesi i automjetit, largon automjetin para se të arrijë automjeti për bartje, paguan 5,00 € për operatorin dhe 10,00 € për Komunën;
- nëse automjeti nuk tërhiqet (rimarret) brenda 48 orëve, pas kësaj kohe, për çdo 24 orë, do të paguhet 8,00 € për Komunën.

8.2. Të gjitha pagesat, nga paragrafi paraprak, do të behën përmes bankës që e cakton Bordi i drejtorëve i Kuvendit të Komunës si të hyra të Drejtoratit;

8.3 Taksat e shërbimeve do t`i vërtetojë Drejtorati i Financave dhe i Pronës.

8.4. Për secilën pagesë do të lëshohet fatura e cila do të jetë rendore dhe do të përmbajë këto të dhëna:

- markën dhe modelin e automjetit,
- numrin e targave,
- emrin e plotë, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të pronarit,
- emrin e plotë, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të personit të cilit i lirohet automjeti,
- datën e bllokimit të automjetit,
- datën e lirimit të automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Neni 9

- 9.1. Drejtorati, herë pas here do t'i kontrollojë të dhënat e operatorit lidhur me shërbimet e bëra, pajisjet dhe vendin për parkim. Drejtorati ka të drejtën e kontrollit të të dhënave edhe pas skadimit, apo të ndërprerjes së kontratës, dhe atë në periudhë prej 5 (pesë) viteve.
- 9.2. Sipas kërkesës së Drejtoratit, operatori obligohet që të sjellë faturat e ruajtura për arkivim në Drejtorat.
- 9.3. Operatori i dorëzon Drejtoratit llogarinë mujore, të punuar sipas nenit 8.2. të kësaj Rregulloreje.
- 9.4. Operatori, në përputhshmëri me nenin 8.2. të kësaj Rregulloreje, do të bëjë pagesat mujore në xhirollogarinë e caktuar nga Bordi i drejtorëve.

Neni 10

- 10.1. Në rast të shkeljes së ndonjërës nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtorati mbanë të drejtën e shkëputjes së kontratës, për çka do të njoftojë operatorin.

Neni 11

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. _____ datë _____ 2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri